

I

(Akte Ligjore)

DIREKTIVA

DIREKTIVA 2013/37/EU E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E
KËSHILLIT

datë 26 qershor 2013

që ndryshon Direktivën 2003/98/EC mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik

(Akt me rëndësi për HEE-në)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Mbështetur në Traktatin për Funkionimin e Bashkimit Evropian dhe veçanërisht në Nenin 114 të tij,

Mbështetur në propozimin e Komisionit Evropian,

Pas transmetimit të projekt-aktit ligjor tek parlamentet kombëtare,

Mbështetur tek opinioni i Komitetit Ekonomik dhe Shoqëror Evropian ⁽¹⁾,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme ligjore ⁽²⁾,

Sipas së cilës:

- (1) Dokumentet që përgatiten nga autoritetet e sektorit publik të Shteteve Anëtare, përbëjnë një burim të madh, të shumëllojshëm dhe të çmuar të burimeve, të cilat janë të dobishme për ekonominë e diturisë.

(1) OJ C 191, 29.6.2012, p.129.

(2) Qëndrimi i Parlamentit Evropian, i datës 13 qershor 2013 (i pashpallur në Fletoren Zyrtare) dhe vendimi i Këshillit i datës 20 qershor 2013.

- (2) Direktiva 2003/98/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 17 nëntor 2003, mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik ⁽³⁾, përcakton një set rregullash minimale, të cilat normojnë ripërdorimin dhe mjetet praktike që lehtësojnë ripërdorimin e dokumenteve ekzistuese, të cilat posedohen nga autoritetet e sektorit publik të Shteteve Anëtare.
- (3) Politika e të dhënave të hapura, e cila nxit disponueshmërinë e gjerësishme dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, për qëllime private apo tregtare, me detyrime minimale ose pa detyrime ligjore, teknike ose financiare dhe e cila promovon qarkullimin e informacionit, jo vetëm për operatorët ekonomikë, por gjithashtu edhe për publikun, mund të luajë rol të rëndësishëm në nisjen e zhvillimit të shërbimeve të reja, bazuar në mënyra të reja të kombinimit dhe përdorimit të këtij informacioni, të stimulojë rritjen ekonomike dhe të promovojë angazhimin e shoqërisë. Gjithsesi, për këtë nevojitet që rregullat në lidhje me autorizimin apo refuzimin për ripërdorimin e dokumenteve, të jenë të harmonizuara në nivel Bashkimi Evropian, gjë që nuk mund të realizohet duke u mbështetur në rregulla dhe praktika të ndryshme të Shteteve Anëtare apo të autoriteteve të përfshira të sektorit publik.
- (4) Autorizimi i ripërdorimit të dokumenteve që posedohen nga një organizëm i sektorit publik përbën një vlerë të shtuar për ri-përdoruesit, për përdoruesit fundorë dhe për shoqërinë në përgjithësi dhe në mjaft raste për vetë autoritetin publik, nëpërmjet promovimit të transparencës dhe përgjegjshmërisë dhe nëpërmjet reagimit të ri-përdoruesve dhe përdoruesve fundorë, gjë që i mundëson organit të sektorit publik përkatës që të përmirësojë cilësinë e informacioneve të mbledhura.
- (5) Që prej miratimit të paketës së parë të rregullave mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik në 2003-shin, sasia e të dhënave në botë, përfshirë edhe të dhënat publike, është rritur në mënyrë mjaft të shpejtë dhe po gjenerohen e mbledhen lloje të ndryshme të dhënash. Paralelisht, jemi dëshmitarë të një evolucioni të vazhdueshëm të teknologjive për analizimin, shfrytëzimin dhe përpunimin e të dhënave. Ky evolucion i shpejtë teknologjik, bën të mundur krijimin e shërbimeve dhe aplikacioneve të reja, të cilat janë krijuar mbështetur në përdorimin, grumbullimin dhe kombinimin e të dhënave. Rregullat e miratuara në 2003-shin, nuk e mbajnë dot hapin me këto ndryshime të shpejta dhe si rezultat, nuk përfitohet nga mundësitë ekonomike dhe shoqërore që ofron ripërdorimi i të dhënave publike.

(3) OJ L 345, 31.12.2003, p. 90

- (6) Ndërkohë, Shtetet Anëtare kanë përcaktuar tashmë politikat e ripërdorimit, bazuar në Direktivën 2003/98/EC dhe disa prej tyre kanë zbatuar qasje ambicioze për të dhëna të hapura, në mënyrë që ripërdorimi i të dhënave publike të aksesueshme të jetë më i lehtë për qytetarët dhe kompanitë, përtej nivelit minimal të përcaktuar nga Direktiva. Për të parandaluar vendosjen e rregullave të ndryshme në Shtete të ndryshme Anëtare, gjë që do të pengonte ofrimin e produkteve dhe shërbimeve ndërkufitare dhe për të mundësuar ripërdorimin e të dhënave publike të krahasueshme, për qëllime të aplikacioneve pan-evropiane, nevojitet një minimum harmonizimi për të përcaktuar cilat të dhëna publike janë të disponueshme për ripërdorim, në tregun e brendshëm të informacionit, në përputhje me kuadrin përkatës të aksesit.
- (7) Direktiva 2003/98/EC nuk përmban asnjë detyrim në lidhje me aksesin në dokumentacion apo ndonjë detyrim për të lejuar ripërdorimin e dokumentacionit. Vendimi për autorizimin ose refuzimin e ripërdorimit, i takon Shtetit Anëtar ose autoritetit të sektorit publik të përfshirë. Ndërkohë, Direktiva 2003/98/EC përcakton rregulla në nivel kombëtar për aksesin në dokumentacion dhe sipas kësaj Direktive, autorizimi për ripërdorimin e dokumenteve për rrjedhojë nuk është i nevojshëm, në rastet kur aksesit është i kufizuar (për shembull, rregullat kombëtare kufizojnë aksesin e qytetarëve ose kompanive, të cilat shprehin interes të veçantë për të pasur akses në dokumente) ose i ndaluar (për shembull, rregullat kombëtare ndalojnë aksesin për shkak të natyrës sensitive të dokumenteve, të cilat midis të tjerave, janë të natyrës së sigurisë kombëtare, mbrojtjes, sigurisë publike). Disa Shtete Anëtare e kanë të lidhur në mënyrë të qartë të drejtën për ripërdorim me të drejtën për akses, kështu që të gjitha dokumentet përgjithësisht të aksesueshme, janë të ri-përdorshme. Në Shtete të tjera Anëtare, lidhja midis dy paketave të rregullave është më pak e qartë dhe kjo përbën një burim pasigurie ligjore.
- (8) Rrjedhimisht, Direktiva 2003/98/EC duhet amenduar, që të përcaktohet një detyrim i qartë për Shtete Anëtare në mënyrë që të gjitha dokumentet të bëhen të ri-përdorshme, përveçse nëse aksesit është i kufizuar ose i ndaluar bazuar në rregullat kombëtare mbi aksesin në dokumente dhe sipas përjashtimeve të përcaktuara në këtë Direktivë. Amendimet që bën kjo Direktivë, nuk synojnë të përcaktojnë apo ndryshojnë regjimin e aksesit në Shtetet Anëtare, i cili mbetet përgjegjësi e tyre.
- (9) Duke marrë parasysh ligjin e Bashkimit Evropian dhe detyrimet ndërkombëtare të Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit Evropian, veçanërisht sipas Konventës së Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike dhe Marrëveshjen mbi Aspektet Tregtare të Pronësisë Intelektuale, dokumentet për të cilat palët e treta zotërojnë të drejtat e pronësisë, duhet të përjashtohen nga qëllimi i Direktivës 2003/98/EC. Nëse një palë e tretë ka qenë zotëruesi fillestar i të drejtave të pronësisë intelektuale për një dokument i cili mbahet nga bibliotekat, përfshirë edhe bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat dhe afati i mbrojtjes së këtyre të drejtave nuk ka përfunduar ende, ai dokument duhet të konsiderohet sipas kësaj Direktive, si një dokument për të cilin palët e treta zotërojnë të drejtat e pronësisë intelektuale.

- (10) Direktiva 2003/98/EC duhet të gjejë zbatim për dokumentet, krijimi i të cilave bën pjesë në detyrat publike të autoriteteve të sektorit publik të përfshira, sikurse përcaktohet me ligj ose me anë të rregullave të tjera të detyrueshme në Shtetet Anëtare. Në mungesë të këtyre rregullave, detyrat publike duhet të përcaktohen në përputhje me praktikën administrative të përgjithshme të Shteteve Anëtare, me kusht që objekti i detyrave publike të jetë transparent dhe të jetë subjekt shqyrtimi. Detyrat publike mund të përcaktohen përgjithësisht ose rast pas rasti për çdo autoritet të sektorit publik.
- (11) Kjo Direktivë duhet implementuar dhe zbatuar në përputhje të plotë me parimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me Direktivën 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 24 tetor 1995, për mbrojtjen e individëve nga përpunimi i të dhënave personale dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave ⁽¹⁾. Veçanërisht, duhet përmendur se sipas asaj Direktive, Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë kushtet sipas së cilave përpunimi i të dhënave personale është i paligjshëm. Gjithashtu, një nga parimet e asaj Direktive është se të dhënat personale nuk duhet të përpunohen më tej nga mbledhja e tyre, në mënyrë të papërputhshme me qëllimet e specifikuar, të qarta dhe të ligjshme, për të cilat u mbledhën ato të dhëna.
- (12) Direktiva 2003/98/EC duhet të zbatohet pa dëmtuar të drejtat, përfshirë të drejtat ekonomike dhe morale, që mund të gëzojnë nëpunësit e autoriteteve të sektorit publik sipas rregullave kombëtare.
- (13) Gjithashtu, kur një dokument është vënë në dispozicion për ripërdorim, autoriteti i sektorit publik të përfshirë, duhet të vazhdojë të ketë të drejtën e shfrytëzimit të dokumentit.
- (14) Fushëveprimi i Direktivës 2003/98/EC duhet të shtrihet tek bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat.
- (15) Një nga qëllimet kryesore të themelimit të tregut të brendshëm, është krijimi i kushteve të favorshme për zhvillimin e shërbimeve në të gjithë Bashkimin Evropian.
-

(¹) OJ L 281, 23.11.1995, p. 31.

Bibliotekat, muzetë dhe arkivat posedojnë një sasi të konsiderueshme burimesh të informacionit të sektorit publik, sidomos që kur projektet e digjitalizimit kanë shumëfishuar sasinë e materialeve digjitale që i përkasin sferës publike. Këto koleksione të trashëgimisë kulturore dhe *metadata*-t në lidhje me to, përbëjnë një bazë potenciale për produkte dhe shërbime me përmbajtje digjitale dhe kanë një potencial tepër të madh për ripërdorim inovativ, në sektorë sikundër edukimi dhe turizmi. Mundësitë më të mëdha për ripërdorim të materialit publik kulturor, duhet midis të tjerash, t'u japin mundësi kompanive të Bashkimit Evropian të shfrytëzojnë potencialin e tyre dhe të kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe në hapjen e vendeve të punës.

- (16) Ekzistojnë ndryshime të konsiderueshme të rregullave dhe praktikave në Shtetet Anëtare, sa i takon shfrytëzimit të burimeve publike kulturore, çka përbën një barrierë për realizimin e potencialit ekonomik të këtyre burimeve. Ndërsa bibliotekat, muzetë dhe arkivat vazhdojnë të investojnë në digjitalizim, shumë syresh vënë në dispozicion materialet me origjinë publike, për qëllime ripërdorimi dhe kërkojnë në mënyrë aktive mundësi për të ripërdorur përmbajtjen e tyre. Gjithsesi, ndërkohë që ata operojnë në kontekste rregullatore dhe kulturore tepër të ndryshme, praktikat e institucioneve kulturore për shfrytëzimin e përmbajtjeve, janë zhvilluar në mënyra të ndryshme.
- (17) Duke qenë se ndryshimet në rregullat dhe praktikat kombëtare, ose mungesa e qartësisë vështirëson funksionimin e duhur të tregut të brendshëm dhe zhvillimin e duhur të shoqërisë së informacionit të Bashkimit Evropian, duhet bërë një minimum harmonizimi i rregullave dhe praktikave kombëtare në lidhje me ripërdorimin e materialit publik kulturor në biblioteka, muze dhe arkiva.
- (18) Shtirja e fushëveprimit të Direktivës 2003/98/EC duhet të kufizohet në tre lloje institucionesh kulturore – bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat, për shkak se koleksionet e tyre janë dhe do të vazhdojnë të jenë gjithnjë e më tepër një material i çmuar për ripërdorim në shumë produkte, sikurse aplikacionet e telefonisë së lëvizshme. Lloje të tjera institucionesh kulturore (sikurse orkestrat, operat, baletet dhe teatrot), përfshirë arkivat e tyre, duhet të mbeten jashtë fushëveprimit për shkak të specifikës së tyre “të bërjes së artit”. Duke qenë se

pothuajse të gjitha materialet e tyre janë të mbuluara nga të drejtat e pronësisë intelektuale të të tretëve dhe për rrjedhojë do të mbeteshin jashtë fushëveprimit të Direktivës, përfshirja e tyre brenda fushëveprimit, do të kishte shumë pak efekt.

(19) Digjitalizimi është një mjet i rëndësishëm për të siguruar akses më të madh dhe ripërdorim të materialit kulturor për edukim, punë dhe argëtim. Ai ofron gjithashtu mundësi ekonomike të konsiderueshme, gjë që mundëson trupëzim më të lehtë të materialit kulturor në shërbimet dhe produktet digjitale, duke ndihmuar kështu në krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike. Këto aspekte janë theksuar ndër të tjera, në rezolutën e Parlamentit Evropian të 5 majit 2010 mbi “Europeana-n – hapat e mëtejshëm”⁽¹⁾, në Rekomandimin e Komisionit 2011/711/EU të datës 27 tetor 2011 mbi digjitalizimin dhe aksesin në internet të materialit kulturor dhe ruajtjen digjitale ⁽²⁾ dhe në konkluzionet e Këshillit të datës 10 maj 2012 mbi digjitalizimin dhe aksesin në internet të materialit kulturor dhe ruajtjen digjitale ⁽³⁾. Këto dokumente përcaktojnë mënyrat e ardhshme të trajtimit të aspekteve ligjore, financiare dhe organizative të digjitalizimit të trashëgimisë kulturore të Evropës dhe paraqitjes së saj në internet.

(20) Për të lehtësuar ripërdorimin, kur është e mundur dhe e përshtatshme, autoritetet e sektorit publik duhet të vendosin në dispozicion dokumentet, nëpërmjet formateve të hapura dhe të lexueshme nga kompjuterët dhe bashkërisht me *metadata*-t e tyre, në nivelin më të lartë të precizionit dhe detajimit, në një format që mundëson ndër-veprim, p.sh. duke i përpunuar ato në mënyrë të përputhshme me parimet që gjejnë zbatim tek normat për përputhshmëri dhe përdorshmëri për informacionin territorial, bazuar në Direktivën 2007/2/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 14 mars 2007, i cili përcakton Infrastrukturën për Informacionin Territorial në Komunitetin Evropian (INSPIRE) ⁽⁴⁾.

(1) OJ C 81, E, 15.3.2011, p. 16.

(2) OJ L 283, 29.10.2011, p. 39.

(3) OJ C 169, 15.6.2012, p. 5.

(4) OJ L 108, 25.4.2007, p. 1.

- (21) Një dokument duhet të konsiderohet i një formati të lexueshëm nga kompjuterët, nëse është në një format skedari të strukturuar në mënyrë të tillë që aplikacionet e programeve kompjuterike të mund ta identifikojnë lehtësisht dhe të nxjerrin prej tij të dhëna të veçanta. Të dhënat e koduara në skedarë që janë të strukturuar në një format të lexueshëm nga kompjuterët, janë të dhëna të lexueshme nga kompjuterët. Formatet e lexueshme nga kompjuterët, mund të jenë të hapura ose në pronësi; ato mund të jenë në standarde formale ose jo. Dokumentet e koduara në një format skedari që kufizon përpunimin automatik, pasi të dhënat mund të ekstrahohen apo nuk mund të ekstrahohen lehtësisht, nuk duhet të konsiderohen si format i lexueshëm nga kompjuterët. Aty ku është e përshtatshme, Shtetet Anëtare duhet të nxisin përdorimin e formateve të hapura të lexueshme nga kompjuterët.
- (22) Kur autoritetet e sektorit publik vendosin tarifa për ripërdorimin e dokumenteve, në parim, ato tarifa duhet të kufizohen tek kostot anësore. Gjithsesi, duhet të merret parasysh që nuk duhet të vështirësohet funksionimi normal i autoriteteve të sektorit publik, të cilave u duhet të gjenerojnë të ardhura, për të mbuluar një pjesë të madhe të shpenzimeve të tyre, sa i takon kryerjes së detyrave të tyre publike ose të kostove që kanë të bëjnë me mbledhjen, prodhimin, riprodhimin dhe publikimin e disa lloje dokumentesh, që vihen në dispozicion për ripërdorim. Në këto raste, autoritetet e sektorit publik, duhet të kenë mundësi të përcaktojnë tarifa në lidhje me kostot anësore. Këto tarifa duhet të përcaktohen në përputhje me kriteret objektive, transparente dhe të verifikueshme dhe të gjitha të ardhurat që burojnë nga vënia në dispozicion dhe autorizimi i ripërdorimit të dokumenteve, nuk duhet t'i kalojë kostot e mbledhjes, prodhimit, riprodhimit dhe publikimit, përfshirë edhe një fitim të arsyeshëm nga investimi. Norma për të gjeneruar të ardhura, për të mbuluar një pjesë të madhe të kostove që bëjnë autoritetet e sektorit publik, në lidhje me kryerjen e detyrave publike ose të kostove në lidhje me mbledhjen, prodhimin, riprodhimin dhe publikimin e disa llojeve të dokumenteve, nuk duhet të jetë një normë ligjore dhe mund të mbështetet, për shembull, nga praktikatat administrative në Shtetet Anëtare. Norma të tilla duhet të rishikohen rregullisht nga Shtetet Anëtare.
- (23) Bibliotekat, muzetë dhe arkivat duhet të kenë mundësi të vendosin tarifa mbi kostot anësore, me qëllim që të mos vështirësohet funksionimi i tyre normal. Në rastin e këtyre autoriteteve të sektorit publik, totali i të ardhurave nga vënia në dispozicion dhe autorizimi i ripërdorimit të dokumenteve, gjatë periudhës përkatëse bugetore, nuk duhet të kalojë shpenzimet e mbledhjes, prodhimit, riprodhimit, publikimit, ruajtjes dhe të përfitimit të të drejtave, duke përfshirë edhe një fitim të arsyeshëm pas

investimit. Për bibliotekat, muzetë dhe arkivat dhe duke pasur parasysh karakteristikat e tyre, tarifat e caktuara nga sektori privat për ripërdorimin e dokumenteve të njëjta apo të ngjashme, duhen marrë në konsideratë kur të përlogaritet fitimi i arsyeshëm pas investimit.

- (24) Tavani i mësipërm i tarifave të përcaktuara nga kjo Direktivë, nuk çënon të drejtën e Shteteve Anëtare për të zbatuar tarifa të ulta ose asnjë tarifë.
- (25) Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë kriteret për vendosjen e tarifave mbi kostot anësore. Për shembull, Shtetet Anëtare mund t'i parashikojnë këto kriteret në kuadrin rregullator kombëtar ose mund të zgjedhin autoritetin përkatës ose autoritetet përkatëse, të ndryshme nga vetë autoriteti i sektorit publik, si kompetent për përcaktimin e këtyre kriterëve. Ai autoritet duhet të funksionojë në përputhje me sistemet kushtetuese dhe ligjore të Shteteve Anëtare. Ai mund të jetë një autoritet ekzistues, me kompetenca ekzekutive buxhetore dhe nën përgjegjësinë politike.
- (26) Në lidhje me çdo lloj ripërdorimi që i bëhet dokumentit, autoritetet e sektorit publik mund të vendosin kushte, nëse është e përshtatshme nëpërmjet një licence, që mund të konsistojë për shembull në citimin e burimit apo që të bëhet e ditur nëse dokumenti është modifikuar në çfarëdo mënyre nga ripërdoruesi. Çdo licencim për ripërdorim të informacionit të sektorit publik, duhet në të gjitha rastet të vendosë sa më pak kufizime për ripërdorim që të jetë e mundur, për shembull duke u mjaftuar me citimin e burimit. Rol të madh në këtë aspekt, do të luajnë licencimet e hapura në internet, të cilat japin të drejta më të mëdha për ripërdorim, pa kufizime teknologjike, financiare apo gjeografike dhe mbështetur në formate të dhënash të hapura. Për rrjedhojë, Shtetet Anëtare duhet të nxisin përdorimin e licencimeve të hapura, çka duhet të shndërrohet më tej, në praktikë të përbashkët për të gjithë Bashkimin Evropian.
- (27) Komisioni ka mbështetur zhvillimin e një table rezultatesh në internet të Informacionit të Sektorit Publik, ku përfshihen indikatorët përkatës të performancës për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik në të gjitha Shtetet Anëtare. Përditësimi i rregullt i kësaj table rezultatesh, do të kontribuojë në shkëmbimin e informacionit ndërmjet Shteteve Anëtare dhe në disponueshmërinë e informacionit në lidhje me politikat dhe praktikat anembanë Bashkimit Evropian.
- (28) Mënyrat e ankimit duhet të përfshijnë mundësinë për rishqyrtim nga një autoritet i pavarur rishqyrtimi. Ky autoritet duhet të jetë një autoritet kombëtar ekzistues, sikurse autoriteti kombëtar i konkurrencës, autoriteti kombëtar i aksesit në dokumentacion ose një autoritet gjyqësor kombëtar. Ai autoritet duhet të funksionojë në përputhje me sistemet kushtetuese dhe ligjore të Shteteve Anëtare dhe nuk duhet të paragjykojë asnjë nga mënyrat e ankimit, të cilat normalisht janë në dispozicion të aplikantëve për ripërdorim. Gjithsesi ai autoritet duhet të jetë i ndryshëm nga mekanizmi i Shteteve Anëtare, i cili përcakton kriteret për vendosjen e tarifave mbi

kostot anësore. Mënyrat e ankimit duhet të përfshijnë mundësinë e rishqyrtimit të vendimeve negative, por gjithashtu edhe të vendimeve të cilat, edhe pse lejojnë ripërdorimin, gjithsesi mund të çenojnë aplikantin në aspekte të tjera, sidomos nëpërmjet rregullave të tarifave që caktohen. Procedura e rishqyrtimit duhet të jetë e shkurtuar, për t'iu përgjigjur kështu nevojave të një tregu në evoluim të shpejtë.

- (29) Rregullat e konkurrencës duhet të respektohen kur përcaktohen parimet për ripërdorimin e dokumenteve, për të shmangur sa më shumë të jetë e mundur, marrëveshjet përjashtuese ndërmjet autoriteteve të sektorit publik dhe partnerëve privatë. Gjithsesi, me qëllim që të jepet një shërbim për interesin publik, mund të jetë ndonjëherë e nevojshme të ekzistojë e drejta për përjashtim nga ripërdorimi i disa dokumenteve specifike të sektorit publik. Midis të tjerash, kjo mund të ndodhë kur asnjë botues komercial nuk do të publikojë informacionin, pa pasur një të drejtë të tillë përjashtuese. Me qëllim që kjo problematikë të merret parasysh, Direktiva 2003/98/EC autorizon marrëveshje ekskluzive, për rastet kur një e drejtë përjashtimi nevojitet për ofrimin e një shërbimi me interes publik, me kusht që të shqyrtohen në mënyrën e duhur.
- (30) Në vijim të shtrirjes së fushëveprimit të Direktivës 2003/98/EC tek bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat, është e udhës të merren parasysh divergjencat që kanë Shtetet Anëtare, sa i takon digjitalizimit të burimeve kulturore, të cilat nuk mund të zgjidhen me efektivitet nga rregullat aktuale të asaj Direktive në lidhje me marrëveshjet përjashtuese. Ekzistojnë marrëveshje të shumta ndërmjet bibliotekave, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë, arkivat dhe partnerët privatë, të cilat përfshijnë digjitalizimin e burimeve kulturore, duke u dhënë partnerëve privatë të drejta përjashtimi. Praktika ka treguar se këto lloj partneritetesh publik-privat, mund të lehtësojnë përdorimin e koleksioneve kulturore dhe në të njëjtën kohë të përshpejtojnë aksesin në trashëgiminë kulturore nga ana e publikut.
- (31) Kur një e drejtë përjashtimi lidhet me digjitalizimin e burimeve kulturore, një periudhë e caktuar ekskluziviteti mund të jetë e nevojshme, me qëllim që t'i japë partnerit privat mundësinë të nxjerrë shpenzimet e investimit të tij. Gjithsesi, ajo periudhë kohore duhet të jetë e kufizuar dhe sa më e shkurtër që të jetë e mundur, me qëllim që të respektohet parimi që materialet e sferës publike të mbeten në sferën publike sapo të digjitalizohen. Periudha e së drejtës përjashtuese me qëllim digjitalizimin e burimeve kulturore, përgjithësisht nuk duhet t'i kalojë 10 vitet. Çdo periudhë ekskluziviteti më e madhe se 10 vite, duhet t'i nënshtrohet rishqyrtimit, ku të përlllogariten ndryshimet teknologjike, financiare dhe administrative që prej kohës kur është lidhur marrëveshja. Gjithashtu, çdo partneritet privat-publik për digjitalizimin e burimeve kulturore, duhet t'i japë institucionit partner kulturor, të drejta të plota sa i takon përdorimit pas përfundimit të burimeve kulturore digjitale.
- (32) Me qëllim që të merren parasysh ashtu siç duhet kontratat dhe marrëveshjet e tjera, të cilat japin të drejta ekskluzive dhe të cilat janë përmbyllur përpara hyrjes në

fuqi të kësaj Direktive, duhen marrë masat e duhura tranzitore, për të mbrojtur interesat e palëve të përfshira, kur të drejtat e tyre nuk përmbushin kriteret për përjashtimet e autorizuara nga kjo Direktivë. Këto masa tranzitore duhet të bëjnë të mundur që të drejtat ekskluzive të palëve, të vazhdojnë të ekzistojnë deri në përfundim të kontratës ose në rastet e kontratave pa kushte përfundimi ose me kohëzgjatje shumë të madhe, të vazhdojnë të ekzistojnë për një periudhë të mjaftueshme, e cila t'u lejojë palëve të marrin masat e nevojshme. Këto masa tranzitore nuk duhet të zbatohen për kontrata apo marrëveshje të tjera të lidhura pas hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, por përpara zbatimit të masave kombëtare për transpozimin e kësaj Direktive, me qëllim që të shmangen situata ku lidhen kontrata apo marrëveshje të tjera afatgjata të cilat nuk përputhen me këtë Direktivë, gjë që pengon miratimin e masave të ardhshme kombëtare për transpozimin. Kontratat dhe marrëveshjet e tjera të lidhura pas hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, por përpara datës së zbatimit të masave kombëtare për transpozimin, duhet rrjedhimisht të përputhen me këtë Direktivë, duke nisur që nga data e zbatimit të masave kombëtare për transpozimin e kësaj Direktive.

- (33) Duke qenë se objektivat e kësaj Direktive, konkretisht lehtësimi i krijimit të produkteve dhe shërbimeve të informacionit bazuar në dokumente të sektorit publik në të gjithë Bashkimin Evropian, për të siguruar përdorim të efektshëm ndërkufitar të dokumenteve të sektorit publik nga kompanitë private në njërën anë, sidomos nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për produkte dhe shërbime informacioni me vlerë të shtuar dhe nga qytetarët në anën tjetër, për të lehtësuar qarkullimin e informacionit dhe komunikimit, nuk mund të përmbushen plotësisht nga Shtetet Anëtare dhe për rrjedhojë, mund të përmbushen siç duhet në nivel Bashkimi Evropian, për shkak të natyrës Pan-Evropiane të aksionit të propozuar, Bashkimi Evropian mund të miratojë masa në përputhje me parimin e vartësisë, sikurse përcaktohet në nenin 5 të Traktatit të Bashkimit Evropian. në përputhje me parimet e proporcionalitetit, sikurse përcaktohet në atë nen, kjo Direktivë nuk shkon përtej asaj çka është e nevojshme për përmbushjen e këtyre objektivave.
- (34) Kjo Direktivë respekton të drejtat themelore dhe zbaton parimet e njohura, veçanërisht të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, përfshirë edhe mbrojtjen e të dhënave personale (neni 8). Asgjë në këtë Direktivë nuk duhet të interpretohet ose zbatohet në mënyrë të papërputhshme me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.
- (35) Është e nevojshme të garantohet që Shtetet Anëtare i raportojnë Komisionit në lidhje me nivelin e ripërdorimit të informacionit të sektorit publik, kushtet me të cilat është vënë në dispozicion dhe praktikat e ankimit.

(36) Komisioni duhet t'i asistojë Shtetet Anëtare në implementimin e kësaj Direktive në mënyrën e duhur, duke publikuar udhëzues, veçanërisht në lidhje me licencat standarde të rekomanduara, setet e të dhënave dhe tarifatat për ripërdorimin e dokumenteve, pas konsultimit me palët e interesuara.

(37) Direktiva 2003/98/EC duhet rrjedhimisht të amendohet në përputhje me rrethanat,

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

Neni 1

Direktiva 2003/98/EC ndryshohet si vijon:

(1) Neni 1 ndryshohet si vijon:

(a) Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

(i) Pika (a) zëvendësohet me paragrafin në vijim:

‘(a) dokumente, vënia në dispozicion e së cilave del jashtë qëllimit të detyrës publike të autoriteteve të sektorit publik të përfshira, sikurse përcaktohet me ligj ose me rregulla të tjera të detyrueshme në Shtetet Anëtare, ose në mungesë të këtyre rregullave, në përputhje me praktikën e zakonshme administrative në Shtetet Anëtare në fjalë, me kusht që qëllimi i detyrave publike të jetë transparent dhe subjekt rishqyrtimi;’;

(ii) Pika (c) zëvendësohet me paragrafin në vijim:

‘(c) dokumente të cilat janë të përjashtuara nga aksesit, për shkak të regjimit të aksesit në Shtetet Anëtare, përfshirë edhe kur bazohen në:

- Mbrojtjen e sigurisë kombëtare (d.m.th siguria shtetërore), mbrojtjen ose sigurinë publike,
 - Konfidencialitetin e të dhënave statistikore,
- Konfidencialitetin e të dhënave tregtare (p.sh. sekrete të biznesit, profesionale ose të kompanive);’;

(iii) Shtohen pikat në vijim:

‘(ca) dokumente, aksesit në të cilat është i kufizuar për shkak të regjimit të aksesit në Shtetet Anëtare, përfshirë rastet në të cilat qytetarët ose kompanitë duhet të provojnë interes të veçantë për të pasur akses në dokumente;

(cb) pjesë të dokumenteve të cilat përmbajnë vetëm logo, stema dhe simbole;

(cc) dokumente, aksesit në të cilat është i përjashtuar ose i kufizuar, për shkak të regjimeve të aksesit bazuar në mbrojtjen e të dhënave personale dhe pjesë nga dokumente të aksesueshme bazuar në ato regjime të cilat përmbajnë të dhëna personale, ripërdorimi i së cilave përcaktohet me ligj si mosrespektim i ligjit për mbrojtjen e individëve nga përpunimi i të dhënave personale;’;

(iv) Pika (e) zëvendësohet me paragrafin në vijim:

‘(e) dokumente që disponohen nga institucione edukimi dhe kërkimi, përfshirë organizatat e krijuara për transferimin e rezultateve të kërkimit, shkollat dhe universitetet, përjashtuar bibliotekat e universiteteve dhe’;

(v) Pika (f) zëvendësohet me paragrafin në vijim:

‘(f) dokumente që disponohen nga institucione kulturore, përveç bibliotekave, muzeve dhe arkivave.’;

(b) Paragrafi 3 zëvendësohet si vijon:

‘3. Direktiva mbështet dhe nuk çënon regjimet e aksesit në Shtetet Anëtare.’;

(c) Në paragrafin 4, fjala “Komuniteti” zëvendësohet me fjalët “Bashkim Evropian”.

(2) Pikat e mëposhtme i shtohen nenit 2:

‘6. “formate të lexueshme nga kompjuterët” nënkupton një format dosjeje të strukturuar në mënyrë të tillë që aplikacionet e programeve të mund ta identifikojnë lehtësisht, ta njohin dhe të ekstrahojnë të dhëna të veçanta, përfshirë formularët individualë të deklaramit dhe përmbajtjen e tyre;

7. “Formate të hapura” nënkupton një format dosjeje, i cili është i pavarur nga platforma e tij dhe i vënë në dispozicion të publikut për ripërdorim, pa kufizime të cilat mund të pengonin ripërdorimin e dokumenteve;

8. “Standard formal i hapur” nënkupton një standard i cili është formuluar me shkrim, i cili shtjellon hollësitë në lidhje me normat për garantimin e ndër-veprueshmërisë së programeve;

9. “universiteti” nënkupton çdo autoritet të sektorit publik i cili ofron edukim të lartë pas sistemit të mesëm shkollor, i cili pajis me diplomë akademike.’.

(3) Neni 3 zëvendësohet me paragrafet në vijim:

‘Neni 3

Parimi i përgjithshëm

1. Bazuar në paragrafin 2, Shtetet Anëtare duhet të bëjnë të mundur që dokumentet e parashikuara në këtë Direktivë, në përputhje me nenin 1, do të vihen në dispozicion për ripërdorim për qëllime komerciale ose jo komerciale, në përputhje me kushtet e përcaktuara në kapitujt III dhe IV.
2. Për dokumentet, të drejtat e pronësisë intelektuale të të cilave rezervohen nga bibliotekat, muzetë dhe arkivat, Shtetet Anëtare do të garantojnë që atëherë kur ripërdorimi i këtyre dokumenteve është i lejuar, këto dokumente të jenë të ripërdorshme për qëllime komerciale ose jo komerciale, në përputhje me kushtet e përcaktuara në kapitujt III dhe IV.’.

(4) Në nenin 4, paragrafet 3 dhe 4, zëvendësohen me paragrafët në vijim:

‘3. Në rastin e një vendimi negativ, autoritetet e sektorit publik, duhet të bëjnë me dije arsyet e refuzimit të aplikantit, bazuar në dispozitat përkatëse të regjimit të aksesit të atij Shteti Anëtar ose të dispozitave kombëtare të miratuara në zbatim të kësaj Direktive, veçanërisht të pikave (a) tek (cc) të nenin 1(2) ose nenit 3. Kur një vendim negativ bazohet në nenin 1(2)b, autoriteti i sektorit publik duhet të përfshijë një referencë në lidhje me personin fizik ose juridik, i cili është titullar i së drejtës, nëse ka dijeni, ose nëse është rasti, të dhënësi i licencës, nga i cili autoriteti i sektorit publik ka marrë materialin përkatës. Bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat, nuk detyrohen të përfshijnë një referencë të tillë.

4. Çdo vendim për ripërdorim, duhet të përmbajë një referencë në lidhje me mënyrat e ankimit, në rast se aplikanti dëshiron të apelojë vendimin. Mënyrat e ankimit duhet të përfshijnë mundësinë e rishqyrtimit nga një autoritet i paanshëm rishqyrtimi, i cili zotëron ekspertizën e duhur, sikurse autoriteti kombëtar i konkurrencës, autoriteti kombëtar i aksesit në dokumente, ose një autoritet kombëtar gjyqësor, vendimet e të cilit janë të detyrueshme për autoritetin e sektorit publik të përfshirë.’.

(5) Neni 5 zëvendësohet me sa vijon:

‘Neni 5

Formatet e disponueshme

1. Autoritetet e sektorit publik duhet t'i vendosin në dispozicion dokumentet në çfarëdo formati apo gjuhe ekzistuese dhe kur është e mundur dhe e përshtatshme, në format të lexueshëm nga kompjuterët së bashku me *metadata*-t që u përkasin. Si formati ashtu edhe *metadata*-t duhet të përputhen me standardet formale të të dhënave të hapura, për aq sa është e mundur.
2. Paragrafi 1 nuk përfshin detyrimin për autoritetet e sektorit publik që të krijojnë apo përshtatin dokumente ose të vënë në dispozicion ekstrakte, me qëllim që të zbatojnë atë paragraf, në rastet kur kjo do të shkaktonte përpjekje jo proporcionale, që shkojnë përtej një veprimi të thjeshtë.
3. Bazuar në këtë Direktivë, autoritetet e sektorit publik nuk janë të detyruara të vazhdojnë prodhimin dhe ruajtjen e disa lloje dokumentesh, për qëllimin e ripërdorimit të këtyre dokumenteve, nga një organizëm i sektorit privat apo publik.’.

(6) Neni 6 zëvendësohet me sa vijon:

‘Neni 5

Parimet që rregullojnë vendosjen e tarifave

1. Kur vendosen tarifa për ripërdorimin e dokumenteve, ato tarifa nuk duhet të kalojnë kostot anësore të riprodhimit, përgatitjes dhe publikimit të tyre.
2. Paragrafi 2 nuk gjen zbatim për sa vijon:
 - (a) Autoritetet e sektorit publik të cilat kanë nevojë të gjenerojnë të ardhura, për të mbuluar një pjesë të rëndësishme të shpenzimeve të tyre, në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre publike;
 - (b) Me përjashtim të dokumenteve, për të cilat autoriteti i sektorit publik të përfshirë duhet të gjenerojë të ardhura të mjaftueshme, për të mbuluar shpenzimet anësore në lidhje me mbledhjen, prodhimin, riprodhimin dhe publikimin.
 - (c) Bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe libraritë.
3. Në rastet e referuara në pikat (a) dhe (b) të paragrafit 2, autoritetet e sektorit publik duhet të përlllogarisin tarifatat totale, në përputhje me kriteret objektive, transparente dhe të verifikueshme, për t’u përcaktuar nga Shtetet Anëtare. Të

ardhurat totale të atyre autoriteteve, nga vënia në dispozicion dhe lejimi i ripërdorimit të dokumenteve, në periudhën përkatëse buxhetore, nuk duhet t'i kalojë kostot e mbledhjes, prodhimit, riprodhimit dhe publikimit, së bashku me një fitim të arsyeshëm mbi investimin. Tarifat duhen përlogaritur në përputhje me parimet e kontabilitetit që zbatojnë autoritetet e sektorit publik të përfshira.

4. Kur tarifat vendosen nga autoritetet e sektorit publik referuar në pikën (c) të paragrafit 2, totali i të ardhurave nga vënia në dispozicion dhe lejimi i ripërdorimit të dokumenteve përgjatë periudhës përkatëse buxhetore, nuk duhet t'i kalojë kostot e mbledhjes, prodhimit, riprodhimit, publikimit, ruajtjes dhe marrjes së të drejtave, së bashku me një fitim të arsyeshëm mbi investimin. Tarifat duhet të përlogariten në përputhje me parimet e kontabilitetit që zbatojnë autoritetet e sektorit publik të përfshira.'.

(7) Neni 7 zëvendësohet me sa vijon:

‘Neni 7

Transparenca

1. Në rastin e tarifave standarde për ripërdorim të dokumenteve që zotërohen nga autoritetet e sektorit publik, çdo kusht që vendoset dhe vetë shumta e atyre tarifave, përfshirë edhe bazën mbi të cilën janë përlogaritur këto tarifa, duhet të paracaktohet dhe të publikohet, në mënyrë elektronike, kur është e mundur dhe e përshtatshme.
2. Në rastin e tarifave për ripërdorim të ndryshme nga ato të referuara në paragrafin 1, autoriteti i sektorit publik në fjalë, duhet të bëjë të ditur që në fillim, cilët faktorë janë marrë parasysh për përlogaritjen e atyre tarifave. Me anë të kërkesës, autoriteti i sektorit publik në fjalë, duhet gjithashtu të bëjë me dije mënyrën me anë të së cilës janë përlogaritur tarifat, që kanë të bëjnë me kërkesën specifike për ripërdorim.
3. Normat e referuara në pikën (b) të nenit 6(2) duhen parapërcaktuar. Ato duhen publikuar në rrugë elektronike, kur është e mundur dhe e përshtatshme.
4. Autoritetet e sektorit publik duhet të garantojnë që aplikantët për ripërdorim të dokumenteve, të jenë të informuar sa i takon mënyrave të ankimit, në lidhje me vendimet apo praktikatat që i prekin ata.'.

(8) Në nenin 8, paragrafi 1 zëvendësohet me paragrafin në vijim:

‘1. Autoritetet e sektorit publik mund të lejojnë ripërdorimin pa kushte ose mund të vendosin kushte, nëpërmjet një licence, kur kjo është e përshtatshme. Këto kushte nuk

duhet të kufizojnë në mënyrë të panevojshme, mundësitë për ripërdorim dhe nuk duhet të përdoren për të kufizuar konkurrencën.’.

(9) Neni 9 zëvendësohet me sa vijon:

‘Neni 9

Rregullimet praktike

Shtetet Anëtare duhet të bëjnë rregullimet praktike, të cilat lehtësojnë kërkimin e dokumenteve në dispozicion për ripërdorim, sikurse lista burimesh të dokumenteve kryesore me *metadata*-t që u përkasin, të aksesueshme në internet, kur kjo është e mundshme dhe e përshtatshme dhe në formate të lexueshme nga kompjuterët dhe portale që janë të lidhura me listat e burimeve. Kur është e mundur, Shtetet Anëtare duhet të lehtësojnë kërkimin ndërgjuhësor të dokumenteve.’.

(10) Neni 11 ndryshohet me sa vijon:

(a) Nën-paragrafi në vijim i shtrohet paragrafit 2:

‘Ky paragraf nuk gjen zbatim në digjitalizimin e burimeve kulturore.’.

(b) Shtohet paragrafi në vijim:

‘2a. Pavarësisht paragrafit 1, ku një e drejtë ekskluzive lidhet me digjitalizimin e burimeve kulturore, periudha e ekskluzivitetit në përgjithësi nuk duhet t’i kalojë 10 vitet. Në rast se ajo periudhë i kalon 10 vitet, kohëzgjatja e saj duhet të jetë subjekt rishikimi gjatë vitit të 11 dhe nëse është rasti çdo shtatë vite pas tij.

Marrëveshjet sipas së cilave jepen të drejta ekskluzive, të referuara në nën-paragrafin e parë, duhet të jenë transparente dhe të bëra publike.

Në rastin e një të drejte ekskluzive, të referuar në nën-paragrafin e parë, autoritetit të sektorit publik të përfshirë, duhet t’i vihet në dispozicion pa pagesë një kopje e burimeve kulturore të digjitalizuara, si pjesë e atyre marrëveshjeve. Kjo kopje duhet të jetë e disponueshme për ripërdorim në fund të periudhës së ekskluzivitetit.’.

(c) Paragrafi 3 zëvendësohet me sa vijon:

‘3. Marrëveshjet ekskluzive ekzistuese deri më datë 1 korrik 2005, të cilat nuk përmbushin kushtet e përjashtimeve sipas paragrafit 2, duhet të përmbillen në fund të kontratës ose në çdo rast, jo më vonë se data 31 dhjetor 2008.’.

(d) Shtohet paragrafi në vijim:

‘4. Pa çënuar paragrafin 3, marrëveshjet ekskluzive ekzistuese deri më 17 korrik 2012, të cilat nuk plotësojnë kushtet për përjashtime sipas paragrafëve 2 dhe 2a, duhet të përmyllen në fund të kontratës ose në çdo rast, jo më vonë se data 18 korrik 2043.’.

(11) Neni 13 zëvendësohet me sa vijon:

‘Neni 13

Rishqyrtimi

1. Komisioni do të rishqyrtojë zbatimin e kësaj Direktive përpara datës 18 korrik 2018 dhe do t’ua komunikojë rezultatet e këtij rishqyrtimi, bashkë me çdo propozim për ndryshim të Direktivës, Parlamentit Evropian dhe Këshillit.
2. Shtetet Anëtare, çdo 3 vjet, do të paraqesin një raport tek Komisioni, në lidhje me disponueshmërinë për ripërdorim të informacionit të sektorit publik dhe kushtet në të cilat vihet në dispozicion, ashtu si edhe në lidhje me praktikën e ankimit. Bazuar në këtë raport, i cili duhet të bëhet publik, Shtetet Anëtare do të kryejnë rishqyrtim të zbatimit të nenit 6, veçanërisht sa i takon tarifave mbi kostot anësore.
3. Rishqyrtimi i referuar në paragrafin 1, duhet veçanërisht të udhëzojë fushëveprimin dhe ndikimin e kësaj Direktive, përfshirë edhe nivelin e rritjen së ripërdorimit të dokumenteve të sektorit publik, efektet e parimeve që aplikohen për vendosjen e tarifave dhe ripërdorimin e teksteve zyrtare të karakterit ligjor dhe administrativ, ndërveprimin midis rregullave të mbrojtjes së të dhënave dhe mundësive për ripërdorim, ashtu si edhe mundësitë e mëtejshme për përmirësim të funksionimit të tregut të brendshëm dhe zhvillimit të industrisë evropiane të përmbajtjes.’.

Neni 2

1. Deri më 18 korrik 2015, Shtetet Anëtare duhet të miratojnë dhe publikojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për përputhjen me këtë Direktivë. Ato duhet të informojnë menjëherë Komisionit për këtë.

Ato duhet të zbatojnë këto masa deri më 19 korrik 2015.

2. Kur Shtetet Anëtare zbatojnë këto masa, ato duhet të përfshijnë referimin tek kjo Direktivë ose t’i shoqërojnë me këtë referencë, kur t’i publikojnë zyrtarisht. Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë se si duhet bërë ky referim.

Neni 3

Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi njëzetë ditë pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 4

Direktiva synon zbatimin në Shtetet Anëtare.

Përgatitur në Bruksel, më 26 qershor 2013.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

M. SCHULZ

Për Këshillin

Presidenti

A. SHATTER
